

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“5th “ shpk

Në Tiranë, sot më datë 08.07.2021, i poshtëshënuari:

- 1- Ernest Qordja, i datëlindjes 28/10/1988, lindur ne Gjakove dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Pasaporte, me numër 560944191

,
me cilësinë e “ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“5th “ shpk**,

Neni 1
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin **“5th sh.p.k.**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka seline në adresë: Rruga “Vilave, Sunrise Residence” prane TEG, Lunder, Tiranë.

Neni 4
Objekti i veprimitarisë

Objekti i veprimitarisë së shoqërisë do të jetë:
Bar-Restoranet, pishine dhe organizim eventesh

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100 lekë, i ndarë në një kuote, i cili zotërohet si më poshtë:

Ernest Qordja zotëron 1 kuotë me vlerë 100 lekë, e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8
Organ i Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirebesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administrimi

Administratore e shoqërisë është:

- Ernest Qordja, i datëlindjes 28/10/1988, lindur ne Gjakove dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Pasaporte me nr.560944191, emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërritjet.

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republiken e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjtë juridike.

Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues të shoqërisë tregtare "5th shpk", nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKËT THEMELUES

Ernest Qordja

